

RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJE TË ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE 2026-2030 NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Plani i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030 në Republikën e Shqipërisë, është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me mbështetjen e Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në Shqipëri “Roma Integration III”.

Projektakti synon të institucionalizojë një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për përfshirjen sociale të pakicave rome dhe egjiptiane, duke kaluar nga ndërhyrje të fragmentuara drejt integritit sistematik të përfshirjes sociale në politikat publike kombëtare dhe vendore.

Në këtë kuadër, Plani adreson në mënyrë të veçantë fushat prioritare të aksesit të barabartë në drejtësi dhe regjistrim civil, strehimit, kujdesit shëndetësor, arsimit dhe dialogut ndërkulturor, punësimit dhe aftësisimit, mbrojtjes sociale, si dhe luftës kundër antigjipsizmit.

Vizioni i Planit të Veprimit është ndërtimi i një shoqërie shqiptare të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe pa diskriminim, ku pakicat rome dhe egjiptiane gëzojnë të drejta, mundësi dhe pjesëmarrje të plotë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Në këtë drejtim, plani synon të sigurojë akses të barabartë në arsim, punësim, strehim, shërbime shëndetësore dhe sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së tyre, fuqizimin social dhe ekonomik, si dhe reduktimin e qëndrueshëm të hendekut social, ekonomik dhe kulturor ndërmjet këtyre komuniteteve dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Plani i Veprimit është në përputhje me objektivat dhe parimet udhëheqëse të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022–2030, si dhe përfaqëson një angazhim strategjik për periudhën 2026–2030, i orientuar drejt adresimit të pabarazive strukturore dhe forcimit të përfshirjes sociale, ekonomike dhe institucionale të pakicave rome dhe egjiptiane. Ky plan veprimi përfaqëson një instrument strategjik të harmonizuar me dokumentet kryesore strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Shqipëria ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor me standardet evropiane, duke krijuar një bazë të konsoliduar ligjore dhe nënligjore për adresimin e çështjeve që lidhen me pakicat rome dhe egjiptiane.

Dokumentet e Bashkimit Evropian, si Korniza Strategjike e BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve 2020–2030, si dhe Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së (Deklarata e Poznań), kanë rëndësi të veçantë për Qeverinë e Shqipërisë në hartimin e këtij Plani Veprimi për integrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane, i cili kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, veçanërisht në lidhje me Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirjen sociale dhe barazinë para ligjit për komunitetet rome dhe egjiptiane.

Projektakti nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projekteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Plani bazohet në përvojën dhe rezultatet e ciklit të mëparshëm strategjik, duke parashikuar përshkallëzimin e masave tashmë të zbatuara dhe të atyre në proces zbatimi, si dhe zhvillimin e ndërhyrjeve të reja të orientuara drejt rezultateve të matshme.

Ky projektvendim synon përfshirjen e plotë të pakicave rome dhe egjiptiane në shoqëri dhe aplikon një qasje të targetuar për adresimin e nevojave specifike të këtij komuniteti, promovon dialog dhe ndërveprim ndërkulturor, respekton diversitetin brenda dhe ndërmjet komuniteteve si dhe integron në mënyrë të qartë dimensionin gjinor në politikat dhe masat e parashikuara.

PKVBPPR/E synon të përcaktojë objektivat afatmesme të Qeverisë për arritjen e vizionit për kohezionin social të përcaktuar në SKZHI-në 2022–2030: *“Mbrojtje, integrim dhe gjithëpërfshirje, nëpërmjet mënjanimit të pabarazive dhe diskriminimit për Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor”*.

Nga 17 objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, PKVBPPR/E 2026-2030 ndërlihet me objektivat 1, 3, 5, 10 dhe 16, si më poshtë:

- Objektivi 1: Fund varfërisë në të gjitha format e saj dhe kudo.
- Objektivi 3: Shëndet i mirë dhe mirëqenie.
- Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.
- Objektivi 10: Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve.
- Objektivi 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.

Gjithashtu, rekomandimet e Strategjisë së Këshillit të Europës për Përfshirjen e Romëve dhe Udhëtarëve (2026–2030), dhe zhvillimet e reja në nivel evropian theksojnë rëndësinë e fuqizimit të grave rome, rritjes së pjesëmarrjes së komuniteteve në proceset vendimmarrëse, forcimit të kapaciteteve të autoriteteve vendore dhe përdorimit të mekanizmave efektivë të monitorimit për matjen e progresit. Përfshirja e këtyre elementeve në Planin e veprimit 2026–2030 mundëson ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të mbështetur në standarde

ndërkombëtare dhe të orientuar drejt rezultateve të matshme, duke garantuar një ndikim real në përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Vlerësimi i impaktit të këtij plani do të shërbejë jo vetëm për të matur arritjen e objektivave dhe rezultateve të planit, por edhe për të informuar rishikimin e politikave publike, përmirësimin e ndërhyrjeve dhe orientimin e strategjive të ardhshme, në përputhje me prioritetet e integritit evropian dhe standardet e Këshillit të Evropës në fushën e barazisë, përfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ku dokument përfaqëson një instrument strategjik të harmonizuar me dokumentet kryesore strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Republika e Shqipërisë ka krijuar një bazë të konsoliduar ligjore dhe nënligjore për adresimin e çështjeve që lidhen me pakicat rome dhe egjiptiane, duke u mbështetur në standardet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Projektvendimi hartohet në mbështetje të kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi, në veçanti Nenet 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kuadri i politikave shtetërore për përfshirjen sociale në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe dokumente të tjera të politikave publike, ndër të cilat: Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026; Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara; Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028; Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2022–2029; Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026; Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2024–2028; Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024–2030; Strategjia e Strehimit Social 2016–2025; Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2024–2025; Strategjia e Kujdesit Shëndetësor Parësor 2020–2025; Plani i Veprimit për Promocionin Shëndetësor 2022–2030; Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021–2030; Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025; Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030; Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2024–2030.

Njëkohësisht, Shqipëria ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor me standardet evropiane.

Projektvendimi reflekton gjithashtu një harmonizim të plotë me parimet udhëheqëse dhe objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) 2022–2030, duke u pozicionuar brenda kornizës kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e qeverisjes dhe përshpejtimin e procesit të integritit evropian.

Njëkohësisht, ky dokument është në harmoni dhe me dokumentet e Bashkimit Evropian, si: Korniza Strategjike e BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve 2020–2030; Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së (Deklarata e Poznań) dhe Konkluzionet dhe rekomandimet e përbashkëta të Seminareve për Romët në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNITAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Plani Kombëtar i Veprimit kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit evropian, veçanërisht në lidhje me Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe Kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore, përfshirjen sociale dhe barazinë para ligjit për komunitetet rome dhe egjiptiane. Ky Plan Veprimi është në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, si dhe me politikat dhe dokumentet strategjike të Bashkimit Evropian në fushën e barazisë, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë Shtyllën Evropiane për të Drejtat Sociale dhe Kornizën Strategjike të BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve 2020–2030.

Ky projektvendim është në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022–2030, dhe synon *“Mbrojtje, integrim dhe gjithëpërfshirje, nëpërmjet mënjanimin të pabarazive dhe diskriminimit për Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor”*.

Gjithashtu, ndërlidhet me disa nga objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, në veçanti objektivat 1, 3, 5, 10 dhe 16, si dhe merr në konsideratë rekomandimet e Strategjisë së Këshillit të Evropës për Përfshirjen e Romëve dhe Udhëtarëve, të cilat së bashku kontribuojnë në garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt rezultateve të matshme për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe integrimin social të komuniteteve rome dhe egjiptiane.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky plan veprimi synon të rrisë akses të barabartë dhe të promovojë një qasje gjithëpërfshirëse në integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane duke parashikuar ndërhyrje në fushat prioritare të politikave publike, si më poshtë:

- Fusha I: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil
- Fusha II: Strehimi
- Fusha III: Kujdesi Shëndetësor
- Fusha IV: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor
- Fusha V: Punësimi dhe Aftësimi
- Fusha VI: Mbrojtja Sociale
- Fusha VII: Antigjipsizmi

I.Fusha: Akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil

Qëllimi i politikës I: “Sigurimi i barazisë së plotë në sistemin e drejtësisë dhe shërbimet civile, përmes eliminimit të barrierave ligjore, administrative dhe financiare për pakicat rome dhe egjiptiane”.

Objektivi specifik:

- Garantimi i mbrojtjes ligjore falas për romët dhe egjiptianët përmes thjeshtimit të procedurave dhe shtrirjes së shërbimeve në nivel vendor.
- Garantimi i integritetit civil të romëve dhe egjiptianëve përmes eliminimit të rasteve të paregjistruara dhe rregullimit të statusit të vendbanimit.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Qytetarët romë dhe egjiptianë të përfitojnë mbrojtje juridike efektive (parësore dhe dytësore) pa asnjë barrierë financiare apo administrative.
- Të arrihet regjistrimi universal i çdo lindjeje dhe përditësimi i adresave të vendbanimit për të gjitha familjet rome dhe egjiptiane, duke siguruar akses të plotë në shërbimet publike.

II.Fusha: STREHIMI

Qëllimi i politikës II: “Sigurimi i strehimit dinjitoz dhe i qëndrueshëm për pakicat rome dhe egjiptiane përmes formalizimit të vendbanimeve dhe integritetit në programet e strehimit social”.

Objektivi specifik:

- Konsolidimi i mekanizmave ligjorë dhe vendorë për përshpejtimin e legalizimit dhe zgjerimin e skemave të strehimit social për familjet rome dhe egjiptiane.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) kanë kapacitete të plota operative dhe buxhetore për të adresuar nevojat për strehim të komuniteteve, duke eliminuar rastet e pastrehisë dhe pasigurisë së pronësisë.

III.Fusha: Kujdesi Shëndetësor

Qëllimi i politikës III: “Garantimi i mbrojtjes së shëndetit dhe aksesit universal në shërbime shëndetësore cilësore për pakicat rome dhe egjiptiane, duke eliminuar pabarazitë në treguesit e jetëgjatësisë dhe mirëqenies”.

Objektivi specifik:

- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore parësore dhe parandaluese përmes afrimit të shërbimit të qytetari dhe eliminimit të barrierave gjeografike e financiare.
- Krijimi, institucionalizimi dhe funksionalizimi i qëndrueshëm i sistemit të mediatorëve shëndetësorë nga pakicat rome dhe egjiptiane.

- Rritja e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e shëndetit nëpërmjet informimit, edukimit, dhe promovimit shëndetësor në komunitetet romë dhe egjiptiane. Reduktimi i përhapjes së sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST) dhe përmirësimi i shëndetit riprodhues në komunitetet romë dhe egjiptiane.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Të rritet ndjeshëm shkalla e mbulimit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore bazë, diagnostikuese dhe parandaluese nga komunitetet romë dhe egjiptianë, duke reduktuar pabarazitë në shëndet.
- Të funksionojë një rrjet kombëtar dhe i mirëfilltë mediatorësh shëndetësorë të integruar në stafin e qendrave shëndetësore, duke siguruar orientimin e komuniteteve dhe rritjen e përfaqësimit të tyre në sistemin mjekësor.
- Të rritet ndjeshëm niveli i njohurive mbi të drejtat shëndetësore dhe shërbimet e disponueshme, duke rezultuar në një rritje të kërkesës për shërbime parandaluese dhe kujdes shëndetësor maternal nga romët dhe egjiptianët.
- Të sigurohet mbulimi i plotë me informim, diagnostikim dhe trajtim falas për SST-të, duke rritur shkallën e zbulimit të hershëm dhe duke minimizuar pasojat afatgjata në shëndetin riprodhues të komunitetit.

IV.Fusha: Arsimi dhe Nxitja e Dialogut Ndërkulturor

Oëllimi i politikës IV: “Forcimi i barazisë së mundësive në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët, nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë si dhe promovimi i dialogut ndërkulturor për romët dhe egjiptianët.”

Objektivi specifik:

- Sigurimi i aksesit, pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit nga nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë përmes masave mbështetëse financiare, sociale dhe institucionale.
- Krijimi i një sistemi arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë, që mundëson pjesëmarrjen e plotë të romëve dhe egjiptianëve në të gjitha nivelet e arsimit.
- Rritja e numrit të programeve, projekteve dhe aktiviteteve publike që promovojnë kulturën romë dhe egjiptiane, si dhe e përfaqësimit të romëve dhe egjiptianëve në institucionet publike të kulturës.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Të rritet pjesëmarrja dhe përfundimi i arsimit nga fëmijët dhe nxënësit romë dhe egjiptianë nëpërmjet mbështetjes arsimore.
- Të rritet frekuentimi dhe vazhdimësia në arsim për nxënësit dhe studentët romë dhe egjiptianë përmes mbështetjes sociale.
- Të rritet numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë përfitues nga skemat financiare mbështetëse në të gjitha nivelet e arsimit.

- Të eliminohen klasat dhe shkollat e segreguara dhe reduktohet ndjeshëm braktisja shkollore e nxënësve romë dhe egjiptianë.
- Të përmirësohet cilësia dhe gjithëpërfshirja e arsimit për romët dhe egjiptianët përmes zhvillimit të kompetencave të stafit arsimor dhe rishikimit të kurrikulave.
- Të rritet ndjeshëm prania e kulturës rome dhe egjiptiane në programet publike kulturore dhe në institucionet e kulturës, krahasuar me vitin 2025.

V.Fusha: Punësimi dhe Aftësimi

Qëllimi i politikës V: “Garantimi i aksesit të barabartë në tregun e punës dhe fuqizimi ekonomik i pakicave romë dhe egjiptianë përmes punësimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.”

Objektivi specifik:

- Rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit, me synim punësimin e qëndrueshëm.
- Nxitja e fuqizimit ekonomik të romëve dhe egjiptianëve përmes mbështetjes së vetëpunësimit, sipërmarrjes sociale dhe integritit në sektorët e ekonomisë së gjelbër.
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe cilësisë së shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Deri në vitin 2030 rritet pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e punësimit, formimin profesional dhe programet aktive të tregut të punës.
- Deri në vitin 2030 rritet niveli i punësimit të romëve dhe egjiptianëve pjesëmarrës në formimin profesional dhe programet e nxitjes së punësimit.
- Deri në vitin 2030 rritet përfshirja e romëve dhe egjiptianëve në skemat mbështetëse dhe mekanizmat e tranzicionit nga ndihma ekonomike drejt punësimit.
- Deri në vitin 2030, është rritur qëndrueshmëria ekonomike e familjeve rome dhe egjiptiane përmes zgjerimit të skemave të vetëpunësimit dhe integritit të tyre në modele të sipërmarrjes sociale, duke rritur numrin e bizneseve të reja të gjeneruara nga këto komunitete.
- Deri në vitin 2030, është arritur një tranzicion efektiv i punëkërkuësve romë dhe egjiptianë nga ekonomia informale drejt punësimit të rregullt e të gjelbër, me fokus në sektorët e riciklimit, menaxhimit të mbetjeve dhe energjisë së rinovueshme.
- Shërbime institucionale me standarde të larta etike dhe profesionale në trajtimin e pakicave rome dhe egjiptiane.
- Institucionalizimi i ndërmjetësimit komunitar si mekanizëm kyç për aksesin në tregun e punës.

VI.Fusha: Mbrojtja Sociale

Qëllimi i politikës VI: “Garantimi i një sistemi mbrojtjeje sociale gjithëpërfshirës që siguron mirëqenien, riintegrimin socio-ekonomik dhe mbrojtjen e pakicave romë dhe egjiptianë, me fokus të veçantë te grupet më vulnerabël dhe reagimin ndaj krizave”.

Objektivi specifik:

- Fuqizimi i sistemit të mbrojtjes sociale për të siguruar mbulim universal, shërbime të integruara komunitare dhe qëndrueshmëri ndaj krizave për familjet romë dhe egjiptiane deri në vitin 2030.
- Forcimi i mekanizmave të mbrojtjes për viktimat e trafikimit dhe shfrytëzimit.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Fuqizimi i skemave të mbrojtjes financiare dhe tranzicioni drejt riintegritit aktiv.
- Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara dhe mbrojtja e grupeve në rrezik.
- Rritja e qëndrueshmërisë ndaj krizave, pandemive dhe fatkeqësive natyrore.
- Të përmirësohet ndjeshëm identifikimi, mbrojtja dhe riintegrimi i romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi ose shfrytëzimi.

VII.Fusha: Antigjipsizmi

Qëllimi i politikës VI: “Garantimi i barazisë gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjes nga diskriminimi për pakicat romë dhe egjiptianë, përmes forcimit të mekanizmave ligjorë, reformave institucionale dhe promovimit të një kulture shoqërore gjithëpërfshirëse”.

Objektivi specifik:

- Integrimi i konceptit të antigjipsizmit në kuadrin ligjor, strategjik dhe në praktikat institucionale të administratës publike.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik për të drejtat dhe kontributin e romëve dhe egjiptianëve në shoqërinë shqiptare.
- Garantimi i mbrojtjes ligjore të barabartë dhe rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare.

Rezultatet e pritshme deri në 2030 janë:

- Shumica e institucioneve publike kanë integruar masa kundër antigjipsizmit në politikat dhe praktikat e tyre.
- Të rritet prania e temave që lidhen me historinë, kulturën dhe të drejtat e romëve dhe egjiptianëve në edukim dhe në hapësirën publike.
- Të rritet fuqizimi i mbrojtjes ligjore dhe reagimit institucional ndaj gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.
- Të rritet përfaqësimi politik dhe fuqizimi i OSHC-ve në monitorimin e politikave publike.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTI

Për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ushtron rolin kryesor koordinues të Planit, përmes strukturave përgjegjëse për përfshirjen sociale dhe

monitorimin e politikave, në bashkëpunim me grupe teknike ndërsektoriale të përbëra nga përfaqësues të institucioneve përgjegjëse.

Njëkohësisht, PKVBPPRE 2026–2030 përcakton qartë përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tij, duke përfshirë ministrinë e linjës sipas fushave përkatëse të Planit si dhe institucione të pavarura dhe mbështetëse si INSTAT, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti i Pakicave Kombëtare, Kuvendi i Shqipërisë dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti sipas fushave të politikave ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur me Urdhrin e Ministrisë Nr. 504, datë 20.10.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektvendimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2026–2030”.

Grupi Ndërinstitucional i Punës është konsultuar me përfaqësues nga ministrinë e linjës, Instituti i Statistikave (INSTAT), si dhe institucionet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Këto institucione kanë kontribuar në ofrimin e të dhënave, përcaktimin e treguesve për monitorimin e progresit sipas fushave të planit dhe identifikimin e aktiviteteve kryesore për përmirësimin e treguesve të impaktit të politikave. Procesi i hartimit është mbështetur gjithashtu nga ekspertiza e Këshillit të Evropës, përmes ekspertëve që kanë asistuar Grupin e Punës në përgatitjen e këtij projektakti.

Projektakti dërgohet për mendim në Ministrinë e Financave; Ministrinë e Drejtësisë; Ministrinë e Punëve të Bredshme; Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit; Ministrinë e Arsimit; Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor; Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), Agjencinë për Mbrojtjen e Vetëqeverisjes Vendore, Avokatit të popullit, Komisionierin për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe Shkollën e Magjistraturës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e këtij projektvendimi është 1,799,629,276 lekë, për periudhën pesëvjeçare të zbatimit të planit (2026–2030). Kjo kosto është përlllogaritur mbi bazën e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në plan dhe është strukturuar sipas 7

fushave prioritare të ndërhyrjes, përkatësisht: akses i barabartë në drejtësi dhe në regjistrim civil; strehimi; kujdesi shëndetësor; arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor; punësimi dhe aftësimi; mbrojtja sociale dhe antigjipsizmi.

Nga kostoja totale e planit, 1,236,993,142 lekë parashikohet të financohen nga buxheti i shtetit dhe burimet e planifikuara të institucioneve përgjegjëse, ndërsa 553,198,240 lekë pritet të financohen nga burime të tjera financimi, përfshirë donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështesin politikën e përfshirjes sociale dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në kuadër të analizës financiare është identifikuar një hendek financiar prej 9,437,890 lekë, i cili do të adresohet përmes mobilizimit të burimeve shtesë gjatë periudhës së zbatimit të planit.

Struktura e kostos përbëhet kryesisht nga kosto korente (rreth 75%), të lidhura me zbatimin e programeve dhe ofrimin e shërbimeve për pakicat romë dhe egjiptiane, si dhe kosto kapitale (rreth 25%), të lidhura me ndërhyrjet infrastrukturore dhe investimet për përmirësimin e aksesit në shërbime publike.

Financimi i masave dhe aktiviteteve të Planit do të reflektohet në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) të institucioneve përgjegjëse dhe do të planifikohet në përputhje me ciklin e planifikimit buxhetor të qeverisë.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Evis SALA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSMINISTËR

Eugena TOMINI

